



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Mbledhja nr. **65/2024**

Data: **02 Dhjetor, 2024. Ora: 14: 00**

Vendi: **Selia e KQZ.**

**Kryesues i KQZ-së:** Kreshnik Radoniqi

**Anëtarët e KQZ-së:** Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të pranishëm:

**U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP:** Besnik Buzhala

**Përkthyes:** Jehona Cami

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

---

**RENDI I DITES**

---

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

---

2. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për miratimin e hapësirave të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore për organizimin e votimit jashtë vendit për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09.02.2025

---

3. Të ndryshme

---

## **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Kryetari **Radoniqi**, paraqiti agjendën e takimit. Ai, pyeti nëse ka ndokush me shtue diçka rreth agjendës.

**Arianit Elshani:** Shkresën, unë e kam pranue dje. Është e 27 nëntorit, dhe afati është deri sot. Shkresat që vijnë me kufizime kohore, nuk ofrojnë kohë të bollshme për tu trajtue. Është një shkresë që vjen nga radha e një partie politike, e një kryetari të një partie. Lidhur me temën që trajtohet në këtë shkresë, kjo temë është mbyllur me 28 gushti kur janë miratue të gjitha qendrat e votimit jashtë vendit. Sipas ligjit, të gjitha subjektet me përjashtim të listës serbe kanë mbështetur votimin fizik në përfaqësi diplomatike, ambasada por mundësisë së kutisë postare që do të hapen jashtë vendit. Sipas ligjit, saktë parashihet se kush duhet të merret me qendrat e votimit. Pra, në këta rast, KQZ.

Nuk ka mundësi që ne ta trajtojmë një shkresë të tillë! Nuk po e kuptoj arsye. Pse nuk duhet të hapen ambasadat, përfaqësitë diplomatike ? Pse po kërkohen qendra të tjera alternative. Lidhur me të gjitha, nuk ka arsye që të hapen salla të ndryshme të mëdha të propozuara. Kemi një përqindje të vogël të aplikimeve. Janë vetëm 6000 qytetarë të vendit me votue fizikisht në përfaqësitë tona diplomatike. Shumica, kanë zgjedhur të votojnë me postë në kutinë postare jashtë vendit.

Në këto momente, kjo çështje nuk duhet të trajtohet. Kemi një shkresë në gusht nga MPJ kur janë miratue qendrat e votimit dhe në atë shkresë potencohet se në Gjermani për shembull, thuhet se votimi mund të mbahet vetëm në përfaqësi diplomatike. Tani, kemi një ndryshim tjetër si për përfaqësitë, si për qendrat e votimit ! Kjo shkresë, sot duket edhe si një ndërhyrje për deri sa nuk kemi raport mbi gjendjen aktuale, pra nuk kemi raport se pse janë këto ndryshime. Kjo shkresë është kontradiktore. Në Shtugard ne kemi miratuar votues deri në 1000 persona, madje janë 50 persona më shumë se kuota në Kosovë e votuesve në një QV. Ndërsa, deri tani kanë aplikuar për votuar vetëm 189 persona. Kjo shkresë, i shërben propagandës kurse ne, duhet ti inkurajojmë votuesit për të aplikuar dhe jo për ta ndryshuar gjendjen. A ja vlen KQZ mu marrë tani me këtë çështje. Edhe letra si është drejtue, përmbajtja që na është drejtue, unë nuk votoj për rendin e ditës...

**Sami Hamiti:** Debatojmë për një shkresë që, kosnideroj se nuk duhet të debatojmë. E para, çështja e hapjes së qendrave të reja të votimit e bënë KQZ, jo ndonjë institucion tjetër. Dihet se, kjo është me ligj. Kjo shkresë, është ndërhyrje direkte në pavarësinë e institucionit tonë. Ligji na ka ngarkuar për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve. Kjo lojë, kjo trysni si kjo, është tejkalim i kompetencave të një organi ekzekutiv në një organ të pavarur. Të na mbajnë ligjëratë! Shikojeni përmbajtjen e kësaj shkrese z. kryetar! Letrën nuk e kemi marrë me kohë me shqyrtue, por sidomos letra bën keqinterpretim të kushtetutës, me vetëdije apo pa vetëdije. Edhe nenet, edhe konventa e Vjenës po ashtu, keqinterpretohen. Se di pse bëhet temë kjo kur, procesi është duke vazhduar.

Mendoj që kjo shkresë as nuk duhet të debatohet dhe as të futet në rend dite...

**Sami Kurteshi:** Këtë shkresë, ju lus t'u dërgohet edhe gazetarëve! Letra është në emër të zëvendëskryeminstres dhe ministres së jashtme. Unë pajtohem se ende nuk ka mbërri numri që me u trajtue jashtë hapësirës që e kemi caktuar. Nuk po shoh përmbajtje që bën presion as te

kryetari, as te KQZ, është vetëm një kërkesë. Ligji na ngarkon që çdo qytetarë ta ketë të drejtën, mundësinë reale për me votue. Çfarë presioni përbënë kjo fjali ? Edhe MPJ si KQZ i ka do detyra: përfaqësimi i cdo hapësire jashtë Kosovës që e bën MPJ është çështje e saj dhe gëzon imunitet, dhe unë i jap të drejtë. Përpjekja për me e kufizue votën e qytetarëve...? Ju, e dini cka ka ngjarë më 2021. Me mijëra dokumente të mërgimtarëve janë keqpërdorë, janë shpërdorua dokumentet, janë shkelë, unë i kam pa vet...! Me mijëra njerëz janë refuzuar...

Tash, tha Kurteshi, është një përpjekje për kufizim të votës. Për mue, është me rëndës si në çdo komunë, me i plotësua të gjitha kushtet. Po, nuk i cakton KQZ se cilat shkolla me votue, ato i ban drejtoria e arsimit, ministria...Me rëndësi është me votue secili qytetarë, për kënd voton është punë e tij. Këto deklarime, janë jashtë rendit të ditës, janë politike! Unë, nuk pranoj asnjë kufizim. Aty ku ka nevojë dhe ka kërkesa, unë jam për me u lejue, me heqë kufizimin, me gjend vend ku me votue... Jam për me e miratue një vendim ku nuk kufizohet numri, me lejue dhe me kërkua prej MPJ që me hapë edhe ndonjë vend që krejt ata që kanë dëshirë me votue fizikisht, me votue. E, infrastruktura nuk është e mjaftueshme në Zvicër, në Gjermani, nuk është hapësira as për 500, e jo për 1000. Ne i kemi miratue, por janë problem, nuk janë të mjaftueshme. Prandaj, unë nuk jam me ba kufizime...

**Ibrahim Selmanaj:** Shkurt, ne kemi bërë vizitë, kemi ba analizë si komision i KQZ. E kemi sjellë një raport që nuk është diskutuar shumë...! Por, ne, e kemi pa realitetin me sy, gjendjen që është në hapësirat tona diplomatike. I kemi vizitue hapësirat tona diplomatike. Për shembull, Sllovenia e ka me ligj që nuk lejohet të votohet jashtë objektit të konsulatës, ambasadës. Po ashtu, e kemi një vendim dhe me ligj ngarkohet ministria e jashtme që të hapen kutitë postare për të cilat nuk kemi raport. Nuk e dimë a është hapu ndonjë, dhe a është ndërmarrë ndonjë iniciativë. Askush nuk është kundër, as me u cënue e drejta e votimit por ne duhet me pas një bazë ligjore që të hapen qendra alternative. Përndryshe, jam kundër që të debatohet dhe futet në rend dite shkresa sepse është e kundërligjshme...

**Ilir Gashi:** Kjo çështje, e ka edhe një kronologji. Por për këtë duhet ba edhe një "kronologji" se si ka rrjedhë situata. Kemi një ligj që është miratuar vitin e kaluar, në qershor me koncensus. Pra, ka marrë miratimin e të gjitha grupeve parlamentare. Ne, mbi këtë ligj, e kemi nxjerrë edhe legjislacionin tonë sekondarë, rregulloret... Pastaj, janë shpall zgjedhjet. Ne, e kemi hartu një plan operacional që e kemi miratuar me koncensus. Plan, i bazuar në ligj. Aty, ne kemi caktuar edhe vendvotimet se ku do duhet ë zhvillohet procesi i votimit në diasporë. Mbi atë plan, ne kemi përcaktuar edhe numrin e atyre që fizikisht mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre. Kemi marrë edhe vendim për numrin e votuesve. Ka pasur disa ankesa se, ne e kemi cënue të drejtën për ta ushtruar votën. Mirëpo, ne kemi 4 vendime të instancave gjyqësore: nga PAZA, e deri te gjykata Supreme. Dhe, vendimet e KQZ – së, vendimet që i kemi marrë kanë dalur të drejta.

Po, tha z. Gashi: shkresa na ka ardhur me vonesë. Po ashtu, shkresa ka ardhur nga një kryetare e partisë, nga Donika Gërvilla që është edhe ministre e jashtme! Pra, mënyra si ka ardhur shkresa është e jashtëligjshme, jo kushtetuese. Nuk e ka këtë drejtë ministria të caktoj shkresa që i takojnë, ekskluzivisht KQZ-së.

E refuzoj debatin, këtë pikë të konsumuar, dhe kjo është çështje e kryer. Prandaj, kërkoj të mos futet në rendin e ditës. Ne, edhe rregulloret, edhe planin e kemi voar me koncensus..

**Sami Kurteshi:** Po manipuloni me mediat dhe publikun ! A ka kërcënim, presion ? Ku ka...?

**Alban Krasniqi:** Ajo që më shqetson mua, ka disa javë që në Kosovë sepse, lufta speciale – hibride është aktive dhe rajoni i Ballkanit mbetet në rrezikshmërinë e dytë të kësaj lufte që bëhet nga Rusia, Serbia. Në një punëtori në Pragë, çështja e dezinformatës me apo pa vetëdije, është vështirë të përcaktohet. Nuk ka përjashtim, mund të bëhemi pre e dezinformatës. Nuk e miratua rendin e ditës se, mirë kish qenë me miratue njëherë rendi ditës, por ne jse! Kjo lufta hibride, ditëve të fundit, u pa me pasojat dhe unë kërkoj të dënohet rasti në veri. Ne, duhet ta japim kontributin tonë, sepse edhe te ne ka impakt ky rast. Aktet e tilla terroriste, na prekin të gjithëve, krijojnë pasiguri te njerëzit.

Edhe ne, mund ti kontribuojmë luftës hibride. Si po e bëjmë ? Po e bëjmë duke dërguar dezinformata tek mediat, opinionistët gjoja se “ministra e jashtme po u përzika në punët e KQZ”...! U përmend edhe memorandum. Është përmend edhe ma herët dhe unë kam kërkuar me reague edhe kryetari, edhe zëdhënësi. Pra, është shpërnda dezinformata dhe, del një tip si Ismet Kryeziu i cili shpërndan dezinformata. Dihet, nuk a sekret se ai është me PDK. Dhe ai, me një analizë rreth fushatës, me një publikim që e ka ba dhe që nuk tregon se kush e ka mbështetur materialisht, por që është i sajuar që përmban nivele të larta të dezinformimit. Në mënyrën si është publiku, referencat që ka ky publikim, citimet që janë ba etj., janë dezinformim i opinionit, dekurajim i mërgimtarëve mos me dalë në zgjedhje. Këto janë pjesë e luftës hibride, dekurajim.

Z. Krasniqi, në vazhdim foli edhe mbi kushtet që janë në përfaqësitë diplomatike, mundësitë reale të tyre sepse, një votues ka probleme. Imagjinoni: në Frankfurt ndodhet qendra e votimit në katin e shtatë! Votimi, nuk mundet me u ba me një infrastrukturë të këfillë. Nuk është marrë askush me këtë, e qëllimi është dekurajomi...

Rregullorja e jonë nr. 17 për Regjistrim dhe Votim Jashtë Kosovës, neni 20, thotë se “jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore KQZ lidh marrëveshje me MPJ në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje”. Ja, cili faj është i ministrisë: se, e ka krye punën tonë. Se, gjoja ata po kshyrin me i marrë kompetencat tona! Janë akuza të ulta, dezinformata...! Kjo, është shpifje dhe unë e inkurajoj zonzjën Gërvalla t’i nisë procedurat, e ju mandej folni...

Qartë: në shkresën e dërguar thuhet se procedurat me hapë një qendër të re votimi merr kohë, e për shembull nëse më 15 dhjetor mbushet vendi, aty ku ka rrezik, sepse prap edhe me 1000 votues jemi tu e pamundësue sepse edhe me 400 votues mbushet vendi sepse votimi merr kohë...E, procedurat marrin kohë. Madje, edhe te ne e kemi pa sa merrë kohë hapja e një qendre të re. Është, shifër e ekzagjeruar “1000” – i, nuk është reale. Se, mund të krijohen tollovi. Veç me lanë rezervë një qendër, jo për tjetër, lejeni ju ligjin sepse po të jetë ashtu, këtu shkelet ligji përditë...

**Sami Hamiti**: U përmend këtu konspiracioni, lufta hibride. Nuk e kamë atë fushë, por vendimmarrjen e kemi ba bashkë. Për 22 shtete bashkë e kemi vendosur “1000” –in. Ju e keni votue, bashkë e kemi votue. Është interferim direkt. A e kemi punue rregulloren ? Jeje konspiracionin. Është interverent i një dege të ekzekutivit. Memorandumi asht mbajt fshehtë një muaj, edhe kjo shkresë vjen 10 orë pa fillue mbledhja...

**Ilir Gashi**: Shkresa, aty ku e përmenda fjalën “kërcënim”, thuhet kështu: “...ndonëse, KQZ nuk i ka krye obligimet ligjore...!” Por, kush është një ministër apo një ministri me na tregue se ne a i kemi kryer apo jo lobliligimet ligjore...? Janë pesë instanca që kanë marrë vendim. Kështu që kjo shkresë, mban kërcënim me këtë mënyrë të përmbajtjes...

**Arianit Elshani**: Unë i kam lexue dy raportet. Njëri nga raporti, thotë se përfaqësitë tona i plotësojnë kriteret për tu zhvillue procesi i votimit. Ndërsa, njëri raport thotë ‘në konkluzione se nuk i plotësojnë kriteret’, mirëpo në foto shihet se i plotësojnë kriteret... Mirëpo, nga 47 mijë që është numri i përcaktuar nga KQZ është mbushë me vetëm 6 mijë...

Unë, kisha pasur dëshirë mu informue për kutitë postare, me u sqarue se ku ka mbetë kjo çështje...!

**Ibrahim Selmanaj**: Zgjedhjet janë duke u mbajtur në Kosovë, dhe jo jashtë...! Ata, i kanë punët më mirë se na. E na, ua zgjedhim telashet nga këtu. E na, për çdo palë zgjedhje rezultatet i kemi pranue... Na, terrenin e përgatisim në bazë të ligjit, ashtu si e kemi përgatitur terrenin...Mos ta diskutojmë këtë si shkresë se, kemi shumë punë për të bërë dhe po shpenzojmë kohë koti...

**Kreshnik Radoniqi**: Ishte një vërejtje, por unë konsideroj se nuk i kemi shkelur detyrimet ligjore. Nuk e kemi nënshkruar memorandumin që e kemi paraparë sepse, nuk kishim kuorum brenda nesh. Por, janë instancat ligjore që përcaktojmë nëse e kemi bërë shkelje ligjore apo jo...?

Shkresa, është dërguar në arkivë dhe mos më bëni mua fajtor që nuk e keni shkresën. Unë, kam kërkuar nga Sekretariati me e verifikuar listën se a është në përputhje me kriteret tona në rregullore, dhe a janë të përshtatshme ato vende ku ka me u mbajte takimi. Kjo listë, është verifikue dhe drejtori ka ba punë shumë të mirë, dhe tani e kemi një pasqyrë shumë të qartë të gjendjes...por, po e shoh që agjenda nuk po votohet. Ama, unë po e hedh në votim...?

Kush është për votimin e kësaj agjende të takimit të sotëm...?

Me 5 vota kundër, 3 vota për dhe 1 abstenim, agjenda e këtij takimi nuk u miratua. Mbledhja, përfundoi vetëm si “shqyrtim, analizë dhe debat paraprak” i agjendës së propozuar...

